

**REPUBLIKA E SHQIPERISE.**  
**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE E ADMINISTRIMIT TE UJRAVE.**  
**AGJENSIA RAJONALE E MJEDISIT QARKU GJIROKASTER.**

Nr 44 Prot



Gjirokaster me 4/10/2006.

**Lenda:** Dhenie mendimi : Mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, Per Projektin dhe Aktivitetin: "Shfrytezim te Ujrave Termominerale dhe Kurative te Banjave te Benjes, qe do te kryhet nga shoqeria "Hasi-Energji" - Sh.p.k. me perfaqesues ligjor z. Hasan Leka.

**DREJTUAR: MINISTRISE MJEDISIT PYJEVE E ADMINISTRIMIT TE UJRAVE**

**TIRANE.**

shoqeria "HASI-ENERGJI" -Sh.p.k. me seli ne qytetin Gjirokaster, Lagja "18 Shtatori" e administrator ligjor z. Hasan Leka, ka paraqitur kerkese per tu pajisur me Leje Mjedisore, per te zbatuar projektin e ndertimit me qellim shfrytezimin e Ujrave Termominerale te Banjave te Benjes, qe jane pjese perberese e deges ujore te lumit te Langarices, baseni ujqor Vjose, afer fshatit Benjes, komuna Petran, rrethi Permet, qarku Gjirokaster.

Ne zbatim te detyrimeve ligjore, shoqeria ka plotesuar gjithe dosjen e plote me dokumentacionin ligjor dhe dokumentacionin teknik te domosdoshem dhe te nevojshem per tu pajisur me Leje Mjedisore.

Per aplikimin dhe zbatimin e projektit shfrytezues shoqeria ka marre mendim dhe miratim nga organet e zgjedhura vendore te komunes Petran, qe jane shprehur dakort per zbatim te projektit dhe kane dhene miratimin me mendimet e vendimet perkatese.

Projekti i shfrytezimit perfshin nje siperrfaqe rreth 7000 m2. Objektet qe do te ndertohen, jane rreth 20 vila me siperrfaqe nga 40 - 150 m2 sejcila. Do te shfrytezohen 4 burimet e ujrave termominerale qe jane me orgjine nga thyerjet tektonike te thella, duke krijuar vija apo carje tektonike qe jane pjese perberese e deges te lumit Langarice ne basenin ujqor Vjose.

Objektet qe do te ndertohen per shfrytezim te ujrave termale perputhen plotesisht me kriteret hidrike dhe hidrogeologjike qe jane kriyer nga struktura te specializuara shteterore per shpallim dhe vlerat kurative qe mbartin keto ujra termominerale.

Ne funksion te studimeve te permendura me lart, shoqeria ka pregatitur me eksperte te specializuara Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

V.N.M.-ne e hartuar jane pershkruar e trajtuar gjithë elementet perberes te mjedisit ku  
net projekti i shfrytezimit te ujrave termale e ne zonen perreth tij.

Jane pershkruar e analizuar topografia, gjeologjia, hidrogeologjia, zonat me status te  
ante per mbrojtje, trashegimia historike, kulturore, ndikimet ne to, e shkalla e ketyre  
ndikimeve.

Krahas pershkrimeve te permendura me lart, ne studimin e hartuar me teper trajtim dhe  
analize duhej te behej per elementet perberes te projektit shfrytezues, duke dhene detaje per  
gjacililin prej tyre si dhe duke specifikuar anet pozitive e negative te sejcilit element te projektit.

Krahas evidentimit te ndikimeve pozitive e negative mjedisore, masat zbutese ndaj tyre,  
duhet trajtuar ne detaje dobishmeria qe ka shfrytezimi i ketyre burimeve ujore ne funksion te  
shendetit te popullates, me ndikim ne kurimin e disa lloj semundjeve dhe perfitimet qe do te kete  
muniteti i komunes Petran dhe popullsia ne rajon.

Ne V.N.M.-ne e hartuar jane pershkruar me hollesi dhe me parametra fizike te matshem  
ndndodhja e burimeve, planvendosja e objekteve qe do te ngrihen ne funksion te shfrytezimit te  
burimeve ujore, siperfaqet dhe habitatet qe preken nga to, si dhe masat zbutese e reabilituese te  
mjedisit gjat dhe pas perfundimit te projektit shfrytezues.

Me teper detaje dhe me parametra fizike konkrete duhej te jepeshin llojet e bimesise  
preken e demtohen nga punimet ndertuese per zbatim te projektit, per punimet regulluese ne  
mjedisin egzistuese, godinat e akomodimit te pacienteve, duke percaktuar dhe masat zbutese e ato  
reabilituese.

Punimet qe kryhen per zbatimin e projektit te shfrytezimit te ujrave termale, nuk prekin  
mjedisin e nuk japin ndikime negative te ndjeshme ne te gjithë luginen, ne vecanti per objektet qe  
duhet shpallur monumente natyre dhe qe kane status te vecante per mbrojtje dhe perdorim.

Theksoj se trajtimi per zonat e mbrojtura duhej bere duke ju referuar akteve ligjore qe  
duhet projekte per mbrojtjen dhe perdorimin e tyre.

Mjedisi ne teresi, me te gjitha pjeset perberese te tij, nuk peson ndryshime te dukshme.

Nuk preken dhe nuk ka premisa qe te shfaqen ndikime negative mbi speciet e rrezikuara  
në mjedis dhe per peisazhin florisitk prej 42 Ha me bimen subendemike te Mellagjerit (*Arbutus  
dracheae*).

Projojekti i shfrytezimit te ujrave termale nuk ndryshon drejtimin e rjedhes ujore egzistuese  
në mjedisin e ujrave, sasine dhe cilesine e tyre.

Ne V.N.M. eshte trajtuar me hollesi kontrolli dhe kujdesi qe duhet te behej shoqeria gjate  
perdorimit te ujrave termale per kurim te pacienteve, duke siguruar ne cdo kohe mjek balneolog,  
qe te dhene rekomandimet dhe receten e nevojshme per perdorim, pasi ne te kundert do te  
shfaqen efekte negative ne shendetin e tyre.

Masat e pershkruara e zgjidhin me se miri kete problem, ne funksion te mbrojtjes dhe  
shendetit te popullates.

Te gjitha punimet per zbatim te projektit ndertues dhe aktiviteti shfrytezues i ujrave  
termale nuk ndikojne ne ndotjen e ujrave siperfaqesore e nentokesore.

asi qe preket nga punimet ndertuese dhe zona perreth tij, ne pergjithesi ruan ekilibrat e natyrore.

ne zone, ne vecanti gjitaret e larte nuk ndikohen nga punimet, ajo leviz ne zone, por ne cdo ruan vendbanimin e saj natyror te perhershem.

Nga aktiviteti ndertues dhe shfrytezues nuk shfaqen ndikime negative ne shendetin e njerimit te sherbimit, pushuseve qe shkojne per kurim, banoreve te fshatrave afer dhe llojet e mesave qe gjenden ne zone.

Burimet ujore termale me aftesi te mira kuruese e sheruese, ruajne vlerat dhe cilesite e natyrore, nuk ndryshojne pembajtja ne % e perberesve kimike dhe treguesit fizike.

Mbetjet inerte qe do te rezultojne nga punimet germuese dhe ndertuese, do te perdoren per nje qe do te shesheve qe do te ndertohen me funksion clodhes e rekreativ per pushuesit.

Fauna ujore e lumit Langarice, ne vecanti llojet e peshkut nuk preken dhe shqetesohen, ne pellgjet ujore termale nuk jane te pranishem, ndersa ne rjedhen ujore te lumit nuk ka ndryshim te regjimit normal te menyres te ushqyerit dhe jeteses se tyre.

Periodikisht, gjat aktivitetit shfrytezues te ujrave termominerale, subjekti qe do marre marrjen e shfrytezimit te tyre, konform aktve ligjore mjedisore, duhet te beje analiza dhe te ujrave, per sasine, cilesine, perberesit kimike, ngarkesen mikrobike dhe treguesit fizike.

Plani I monitorimit te hartohet me i detajuar me tere indikatoret e tij, me parametra te matshem, dhe i ndare ne kohe, per tere periudhen e shfrytezimit.

pej me qarte dhe me te dhena konkrete teknike vendndodhja e dhomave si dhe vaskave qe sherbejne per kurim te pushuseve. Te hartohet program me masa konkrete ne raste te ndotje te menjeherme te mjedisit.

Monitorimi i projektit te shfrytezimit dhe mjedisit perreth tij te kryhet konform V.K.M.-se 03 date 31.03.2002. "Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise.

**Perfundimisht: Duke shqyrtuar dhe analizuar tere dokumentacionin ligjor e teknik, ne bashkete me Komitetin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, Studimin Hidrogeologjik, te paraqitur nga Komiteti i Mjedisit dhe Komiteti i Mjedisit "HASI-ENERGJI-Sh.p.k. dhe duke pare e verifikuar nga afer teritorin dhe zonen e ndertimit te zbatohet projekti i ndertimit per shfrytezim te ujrave termominerale te Banjave te Termaleve ne komunen Petran, ne perputhje me kerkesat e legjislacionit mjedisor per mbrojtjen e mjedisit, jemi te mendimit qe :**

**1. Komiteti i Mjedisit "HASI-ENERGJI-Sh.p.k." me seli ne Gjirokaster e administrator ligjor z. Hasan Haxhiu, te pajiset me Leje Mjedisore, duke plotesuar e respektuar kushtet e meposhteme:**

Te behet kujdese dhe te monitorohen ne vijimesi monumentet natyrore dhe ato historiko-kulturore qe mund te ndikohen nga projekti shfrytezues dhe vargu i kanioneve pergjate luginet e Langarices.

Ne rast te prekjës apo ndikimit te projektit shfrytezues ne to, te respektohen aktet ligjore te paraqitura ne Ligjin "Per Zonat e Mbrojtura".

at kujdese per menaxhimin e mbetjeve urbane qe krijohen nga publiku pushues,  
i grumbulluar dhe hedhur ne vende te miratuara nga subjekti ne bashkepunim me  
ntetin lokal.

e punohet per te mbrojtur gjelberimin egzistues dhe te punohet per te krijuar peisazh me  
mjedise clodhese e rekreative per pushuesit.

Te dergohet informacion cdo tre muaj ne Agjensine Rajonale te Mjedisit, per monitorimin  
dhe masat zbutese e rehabilituese.

5. *Te zbatohen me rigorozitet detyrimet ligjore:*

ligji Nr, 9115 date,24.07.2003 "Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotura".

ligji Nr, 9010 date,13.02.2003, "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta".


K.M. Nr, 177 date,31.05.2005, "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret  
onimit te mjediseve ujore prites.

ligji, "Per Zonat e Mbrojtura".

*Agjensia Rajonale e Mjedisit Qarku Gjirokaster.*

*Inspektori.*

*/ Vladimir Dosti /*



*Kryetari I A.RM.se.*

*/ Asqeri Buzheri /*

